



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.359/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Faton Ademi dhe Rustem Thaçi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega ne Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të largimit dhe heqjes së posterit/bilbordit të kandidateve për deputet te subjektit politik LDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.359/2021 e datës 09.02.2021, e paraqitur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega ne Istog, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), t'i shqiptohet gjobë për shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e largimit dhe heqjes së posterit/bilbordit të kandidateve për deputet te subjektit politik LDK.

A r s y e t i m

Më datë 09.02.2021, subjekti politik nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega ne Istog, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datën 08.02.2021 rreth orës 23:00 në objektin publik banesor në rrugën 20 Qershori në Istog ne ballinën e anës jugore te këtij objekti, nga kandidati i AAK-se për deputet ne parlamentin e Kosovës Bekë Berisha fillimisht i është hequr baneri i LDK me përmasa 7.80 m x 3.40 m me kandidatet për kryeministër Avdullah Hoti dhe tre kandidateve për deputet Shkëmb Manaj, Ilir Ferati dhe Besart Dreshaj dhe në të njëjtin vend pa të drejt ka vendosur banerin e vet me të njëjtin përmasa. Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i subjektit politik AAK është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33 pika a), dhe si dëshmi ka bashkangjitur dy fotografi nga vendi i ngjarjes.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.02.2021, subjekti politik AAK thekson se vendosja e këtij posterit-baneri nuk përbën shkelje sepse hapësira në fjalë është e projektuar për reklama, dhe se hapësira ne te cilën është vendosur baneri reklamues edhe para zgjedhjeve edhe gjatë zgjedhjeve kjo hapësirë reklamuese menaxhohet nga kompania “Selmans Network” sh.p.k pasi që e njëjta hapësirë është marrë në shfrytëzim me vendim të Drejtorisë për planifikim Urban dhe Mjedis ne Komunën e Istogut, andaj këtë hapësirë reklamuese subjekti politik AAK e ka marre ne shfrytëzim nga kompania “Selmans Network” e cila menaxhon me këto hapësira reklamuese ne komunën e Istogut. Si dëshmi ka bashkangjitur vendimin nr 1-116/19

te datës 17.09.2019 të Drejtorisë për planifikim Urban dhe Mjedis në Komunën e Istogut, si dhe Deklaratën –konfirmimin nr. 09-02/2021 i lëshuar nga kompania “Selmans Network”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar,

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesë lidhur me shkeljen e pretenduar të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33 pika a), nga ana e subjektit politik AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika a) të LZP-së, për arsye se hapësira në fjalë edhe më herët është shfrytëzuar për reklamim, dhe e njëjta menaxhohet nga kompania “Selmans Network” me te cilën subjekti politik AAK ka marrëveshje për vendosjen e posterave apo bilbordve.

Andaj Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se subjekti politik AAK ka larguar posterat-bilbordin e kandidatëve te subjektit politik LDK, kjo për faktin se poster- bilbordi i kandidatit për deputet të subjektit politik AAK Bekë Berisha është i vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, e për të cilin subjekti politik AAK ka marrëveshje me kompaninë “Selmans Network” e cila menaxhon me këto hapësira reklamuese në komunën e Istogut ashtu siç vërtetohet edhe nga deklarata-konfirmimi Nr.09-02/2021 e lëshuar nga kjo kompani si dhe Vendimi nr 1-116/19 i datës 17.09.2019 i lëshuar nga Drejtoria për planifikim Urban dhe Mjedis në Komunën e Istogut me të cilën kjo hapësirë reklamuese i është dhënë në menaxhim kompanisë në fjalë.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.359/2021 më datë 11.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.